

Todor Trajanoski

## ETNONIMI ARBËR-ALBAN NË GOJËDHËNAT POPULLORE NDËR VLEHTË E STRUGËS

Të dhënat e njohura për domethënien e etnonimit *Albanos*, *Albanes*, *Arbër*, si kategori të posaçme gjuhësore dhe shkencore, në mënyra të caktuara theksohen në shkencë. Këto kategori dhe nocione lidhur me etnonimin *Arbër* janë parashtruar drejt dhe janë definuar si duhet.

Por në anë të këtij artikulli japim disa gojëdhëna popullore që janë të pranishme ndër vllehtë e Strugës, lidhur me gjenezën dhe domethënien e etnonimit *arbër*. Populli shqiptar ndër vllehtë e kësaj ane dhe më gjerë është i njohur me emrin *Albanes*, *Arbines*.

*trohet* Vjen pyetja se ç'përmbajnë këto gojëdhëna?

Gojëdhëna I

**Emri *Albanes* ka lindur për shkak të ngjyrës së bardhë të veshjes popullore shqiptare**

Sipas kësaj gojëdhëne të vllëve të Strugës del se ky popull e ka marrë emrin *Albanes* për shkak të ngjyrës së veshjes popullore, që shqiptarët tradicionalisht, me shekuj e kanë mbajtur dhe e mbajnë edhe sot me konsekuencë. Kjo të shtyn të besosh kur dihet se fjala „*Alba*” në gjuhën e vllëve (aromunëve) nënkupton sende që janë të bardha e sidomos veshje të bardhë e në këtë rast veshja e shqiptarëve gjithmonë ka qenë e bardhë: plisi i bardhë (e kjo është njëkohësisht edhe një karakteristikë nacionale e këtij populli), këmishë të bardhë, xhamadan i bardhë, brez i bardhë, tirqit e bardhë dhe çorapë të bardha. Pra është e natyrshme dhe e logjikshme që për shkak të ngjyrës së bardhë të veshjes së tyre, ky popull ta ketë marrë emrin e tij etnik *Albanes* ose *albanes* e pastaj edhe *arbër* etj. që do të thotë njerëz të veshur në të bardha.<sup>1</sup>

<sup>1,2</sup> Këto dy gojëdhëna i kam dëgjuar nga *Gjorgji Baja* nga Belica e Poshtme, Strugë. Ky ka vdekur në moshën 80 vjeçare si dhe nga *Joan Zgalla*, poashtu nga fshati Belicë e Poshtme, që tani jeton në Rumani, në moshën 87 vjeçare.

## Gojëdhëna II

### Emri *Arbines* lidhet me vendbanimet e tyre

Kjo gojëdhënë flet se emri i këtij populli „*Arbines*”, vjen nga vendbanimet e tyre. Gjatë lashtësive duke jetuar në vendbanime të papërshtatshme, në viset malore të këtij trolli, larg nga çdo ndikim, pikërisht ky ambient gjeografik, natyror, social dhe ekonomik ka kushtëzuar edhe emrin përkatës për popullin që jetonte dhe punonte në një ambient të tillë. Sipas kësaj gojëdhëne paçuria e maleve shqiptare me drurë dushku (që vllahisht i thonë *Arbure*, *arbre*) është e besueshme të thuhet se vjen dhe emri *Arbines* apo *arbëresh* që do të thotë se emërton një popull që jetojnë në aso visesh ku ka drurë dushku.

Në kushte të tilla, të izoluar, me raportet e veta sociale juridike dhe ekonomike si dhe me mënyrën e posaçme të jetës, shqiptarët janë mbyllur në kornizat fisnore e për këtë shkak vllhtë (aromunët) i quajten *Arbineshi*, *arbëresh* që do të thotë popull që jeton në vende ku ka dushqe, pra *Arbines*, ndërsa vendin e tyre *Arbania* apo *Arbëria*.<sup>2</sup>

Edhe në regjionin e Strugës, saktësisht në fshatin Belicë e Epërme, në Kodrën e Belicës janë të pranishme toponimet: „*Arburet*”, „*Arbreshi*” që në njëfarë mënyre sqarojnë thelbin e këtyre fjalëve apo nocioneve.

Emri etnik i shqiptarëve sipas traditës gojore të vllhëve të Strugës (Albanez, arbines) gjithsesi është pa baza shkencore. Megjithatë, gojëdhënat, si të tilla, gjithsesi janë pasqyrim dhe shprehje e jetës së përbashkët në të kaluarën, prandaj edhe mund të jenë me interes.

Dihet se vllhtë e Strugës kanë jetuar më së shumti në Shqipëri, prandaj është krejtësisht e kuptueshme që kanë ruajtur traditën e jetës së përbashkët që kanë bërë në të kaluarën. Duke jetuar në fqinjësi e jetë vëllazërore shqiptarët dhe vllhtë gjithnjë i janë dashur njëri tjetrit. Pikërisht për këtë supozohet se emri *vllh* apo *vllah* është fjalë shqipe, me të cilën vllhtë u quajten nga shqiptarët e që do të thotë se i kanë konsideruar si vëllazër, pra *vëlla*. Sipas kësaj edhe rreth çështjes së emrit të shqiptarëve (Albanez, arbines), zotëron mendimi, gjithsesi në mesin e vllhëve, se e kanë marrë emrin e tyre prej vllhëve, që gjithsesi ka etimologji romane.

Është gjithashtu me interes të theksohet edhe një dukuri si të shqiptarët ashtu edhe të vllhtë lidhur me emrin e tyre etnik apo kur duan të shpehin përkatësinë etnike nuk thonë as *Albanez* as *vllh*, por gjithmonë *shqiptar* gjegjësisht *aromun*.